

Statut  
i  
Shoqerise "VOLTAIKE 24" sh.p.k

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**  
**Data e Themelimit,**  
**Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 14 / 12 /2023 ,unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **VOLTAIKE 24 sh.p.k**

- **Themeluesi i shoqërisë:**

Z. Fatmir Musaku, shtetas shqiptar, lindur më 16.05.1956 në Qeret, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr letërnjoftimi: 036626789 dhe Nr Personal: F60516050D, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Forma dhe emri ligjor i shoqërisë; **VOLTAIKE 24 sh.p.k**

**Neni 2:**  
**OBJEKTI**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import-eksport dhe tregeti me shumice e pakice te artikujve elektrike, hidraulike, industrial, materiale ndertimi, elektronike, fotovoltaike, aksesore te ndryshem, paisje te sigurimit teknik, etj.

Tregtim me shumice dhe pakice te materialeve te ndryshme elektrike dhe pajisjeve te tyre etj. Projektim, zbatim, ndertim, mirembajtje te impjanteve te prodhimit te energjise elektrike me sistem Fotovoltaiik.

Tregtimi i paneleve voltaike dhe instalimi i impjanteve fotovoltaike per prodhimin e energjise elektrike,

Punime dhe instalime per nenstacione, kabina transformator, linja TN.TM , i linjave dhe gabinave TU, linja per rrjetin telefonik etj. Ndricim dhe sinjalizim urban.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Per te arritur objektin e saj Shoqëria mund te realizoje drejteperdrejte apo ne menyre te terthorte cdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja si dhe te lidhe kontrata shitblerje, perdorimi, shkembimi, sipennarrje apo marreveshje te tjera me investiture, bashke investiture etj.

**Neni 3:**  
**KOHËZGJATJA**

Shoqëria do ta zhvilloj aktivitetin e saj për një periudhë kohore **me afat te pacaktuar** duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 4:**  
**SELIA**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

Tirane Tirane TIRANE Bulevardi "Gjergj Fishta" Nd.14,H20,Ap 19 zona kadastrale 8380 Nr.pasurise 7/540+1-14 Njesia administrative 10, 1001 Tirane 1001.

Asambleja e ortakëve ka kompetencën të hapë filiale e agjenci të tjera dhe të mbyllë ato brenda dhe jashtë Shqipërisë, nëse e konsideron të nevojshme.



**KREU II**  
**KAPITALI I SHOQERISE, TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**Neni 5**  
**KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100,000** Lekë (njëqind mijë) lekë.

1. Ortaku themelues dhe kuota e zotëruar prej tij në Shoqëri është si më poshtë:
  - **Z. Fatmir Musaku**; Zoterues i **1 (një)** kuote prej 100% ose me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqind mijë lekë) që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 6:**  
**KALIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT TEK TE TRETET**

Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje ,dhurim,trashegimi,pse me cdo menyre tjeter te parashikuar nga legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 7:**  
**BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit te Shoqerise mund te rendohen lirisht me barre siguruese apo te drejta te tjera reale.

**KREU III**  
**ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET**

**Neni 8:**  
**ORTAKET E SHOQERISE**

Ortaket e Shoqerise jane:

Z.Fatmir Musaku shtetas shqiptar, lindur më 16.05.1956 në Qeret, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr letërnjoftimi: 036626789 dhe Nr Personal: F60516050D i cili është ortak i vetem.

**Neni 9:**  
**ORGANET E SHOQERISE**

Organet e Shoqerise jane:

- a-Asambleja e pergjithshme.
- b-Administratori/et.

**Neni 10:**  
**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme e thirrur dhe e mbledhur rregullisht ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithe ortaket.

Asambleja e Pergjithshme mbidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut ,nga ligji per shoqerite tregtare ,ligje te tjera dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne cdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje.Njoftimi per mbledhje behet me shkrim ku permban vendin,daten,oren dhe rendjne dites se mbledhjes.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administrator

Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme dhe te jashtezakonshme.



**Neni 11:**  
**ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

Asambleja e zakonshme mbledhet, çdo vit, brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorit, inventareve dhe llogarive vjetore.

**Neni 12:**  
**ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME**

Asambleja e Pergjithshme thirret në sesion të jashtëzakonshëm sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të shoqërisë.

Vendimet që kanë të bëjnë me (por jo vetëm me to) ndryshimin e nënve të Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, prishjen e Shoqërisë konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.

**Neni 13:**  
**KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PERGJITHSHME**

**Asambleja e Pergjithshme vendos:**

- Përcaktimin e politikave tregtare.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe caktimin e shpërblimit të tyre.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuidatorit/eve dhe ekspertëve kontabel të autorizuar dhe shpërblimit të tyre.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/et, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- Miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë.
- Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykate dhe në procedime të tjera kundër administratorit/eve.
- Shpërndarjen e fitimeve.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjes së Asamblesë.
- Çështje të tjera të caktuara nga ligji ose nga ky Statut.
- Kërkesa për kredi bankare dhe/ose nënshkrimi i faturave, garanci ose garanci në favor të paleve të treta.

**Neni 14:**  
**FINANCIMI I SHOQËRISE**

Organi i Administrimit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë. Financimet e metejshme të ortakut/ve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim në varesi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

**KREU IV**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISE**

**Neni 15:**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISE**

Shoqëria administrohet nga një administrator;

Z. Fatmir Musaku shtetas shqiptar, lindur më 16.05.1956 në Qerret, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr letërnjoftimi: 036626789 dhe Nr Personal: F60516050D. Afati i emeritimit të administratorit është nga data 14.12.2023 e nënshkrimit të statutit dhe përfundon me datë 13.12.2028.

I cili zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme për një periudhë 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra në çdo kohë me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Pergjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.



Administratori zoteron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise pervec atyre qe ligji apo ky Akt themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese se Pergjithshme apo organe te tjera te Shoqerise.

Administratori vepron ne perputhje me politikat tregtare nga Asambleja e Pergjithshme.

Administratori eshte pergjegjes per veprimet e kryera ne administrimin e shoqerise.

Administratori mund te delegoje persona te trete per kryerjen e veprimeve dhe akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise duke mbajtur pergjegjesi per te gjitha veprimet kryera ng ate tretet e deleguar per administrimjn e Shoqerise

**Neni 16:**  
**SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT**

17.1 Asambleja e Pergjithshme percakton shperblirnin e Administratorit te Shoqerise.

**Neni 17:**  
**PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT**

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se;

- I perfundon afati emerimit.
- Shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme.
- Jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine.
- Personi nuk gezon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit
- Mungon pa arsye ne detyre per me shume se 6(gjashte)muaj radhazi dhe asambleja e pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

**KREU V**  
**KONTROLLI KONTABEL I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR**

**Neni 18:**  
**KONTROLLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptare ne fuqi. Ortaku/et do te emerojne nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

**Neni 19:**  
**VITI FINANCIAR**

Viti financiar I Shoqerise fillon ne 1 janar dhe rnarbaron ne 31 dhjetor te cdo viti. Si perjashtim, viti i pare financiar i veprimtarise se shoqerise fillon nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtare te Qendres Kombetare te Biznesit

**Neni 20:**  
**BILANCI VJETOR**

Me mbylljen e secilit vit financiar Administratori/ret marrin masa per hartimin e bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur ne menyre qe ortaku/et te vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuaj me ligj.

Ortaku/et vendos mbi ndarjen e dividenteve qe rezulton si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht pasi nga keto shuma jane zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme.

Ortaku/et ne çdo moment mund te vendosin per krijimin e rezervave si dhe per masen e tyre.



**KREU VI  
PRISHJA DHE LIKUJDIMET**

**Neni 21:  
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Ne rastin e likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr.9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (i ndryshuar).

**Neni 22:  
NJOFTIMET**

Te gjitha njoftimet, kerkesat ose komunikimet e tjera qe u jepen personave ose qe bejne personat sipas Statutit do te kryhen me shkrim ose nepermjet komunikimit elektronik dhe do te konsiderohen te kryera ne menyre te rregullt kur u dergohen ne adresat e deklaruarat prej tyre prane Administratorit te shoqerise. Per kete qellim brenda 5(pese) diteve nga regjistrimi efektiv i cdo ortaku (si i tille) ne regjistrin tregtare ky i fundit eshte i detyruar ti komunikoj administratorit adresen e postes elektronike ku deshiron te marri njoftimet, brenda te njejtit afat i komunikon administratorit te Shoqerise adresen e re, kur kjo adrese ndryshon ne te kundert njoftimi konsiderohet si i kryer rregullisht.

Njoftimet zyrtare te komunikimeve me ane te mjeteve elektronike vertetohen sipas legjislacionit per nenshkrimin elektronik dhe dergohen ne adresat elektronike te deklaruarat prej tyre.

**KREU VII  
DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

**Neni 23:  
LIGJI I ZBATUESHEM**

Shoqeria do ta zhvilloj aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt Themelimi dhe Statut te Shoqerise si dhe me ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Akt do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptare perkates ne fuqi.

**Neni 24:  
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne Shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim.

Ne qofte se nuk arrihet mirekuptimi midis paleve per zgjidhjen e mosmarreveshjes atehere do te jete Gjykates se Rrethit Gjyqesor ne qytetin qe i takon kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

**Neni 25:**

Ky Statut dhe Akt Themelimi hartohet ne 5(pese) kopje origjinale ne gjuhen shqipe per tu administruar sipas ligjit.

**ORTAKËT  
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR VOLTAIKE 24 sh.p.k**

**Z. Fatmir Musaku**

*Fatmir Musaku*  
*[Signature]*

**Shenim: Ky dokument shërben edhe si akt themelimi i shoqërisë.**